



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.867/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gllagjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Faruk Hyseni, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Faruk Hyseni, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, në Vendvotimet 2511D/01R, 2523D/02R, 2515D/02R, në Ferizaj.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Faruk Hyseni, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me të cilën ka pretenduar se në vendvotimet: 2511D/01R, 2523D/02R, 2515D/02R, në Ferizaj, sipas deklaratave të votuesëve ata kanë votuar subjektin politik AAK me nr.50 dhe kandidatin e atij subjekti kandidatin me nr.5 Faruk Hyseni, andaj ka kërkuar që të bëhet evidentimi i shkeljës së ndodhur gjatë numërimit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) vendvotimet e cekura në pikën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura miratoj apelin si të bazuar në mbështetje të nenit 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*. Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.867/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.